

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	RTSH ndryshon identitetin vizual dhe programacionin, pesë produksione ndërkombëtare në sezonin e ri
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/rtsh-ndryshon-identitetin-vizual-dhe-programacionin-pese-produksione--i401447
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 11:40:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 11:32:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6e63aee7a1b95a72ff3ebe6aa78f3d837cc77aff0743f2a0461851ca9f488697
TEKSTI	f9dc6a13d33ed13e6b6da38dcd8aedce7069522d36d0370cb2bc213495388974
PAMJA	b98a12f490f1404f59aa0c8d3df6e024c8a10601cc8dbdb99942ef7021a2c332

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	00a268ec57db883f4d27db682e5365f8936013e9e5f535f604ccada6d585e1bc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e203f033d074a2d3c42a790e4ddfadf0e6c8e1c0300d49c3347be227adaa7f43
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/00a268ec57db883f4d27db682e5365f8936013e9e5f535f604ccada6d585e1bc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

[Kreu](#)
[Politikë](#)
[Aktualitet](#)
[Ekonomi](#)
[Kulturë & Art](#)
[Rajon](#)
[Sport](#)
[Bota](#)
[Showbiz](#)
[SocialBomb](#)


Çështjet kryesore

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

Aktualitet

17 Shtator 2026, 13:32

RTSH ndryshon identitetin vizual dhe programacionin, pesë produksione ndërkombëtare në sezonin e ri



Shkruar nga Newsbomb



Eni Vasil, drejtoresha e përgjithshme e RTSH

Radio Televizioni Shqiptar do të nisë sezonin e ri televiziv me një identitet të ri vizual, ndryshime në programacion dhe zgjerim të pranisë në platformat digjitale. Risitë u prezantuan të mërkurën gjatë një aktiviteti në hollin "Gjon Simoni", ku RTSH bëri të ditur edhe disa nga projektet që do të sjellë në ekran.

Ndryshimet përfshijnë grafikën e kanaleve, figura dhe formate të reja televizive, si dhe një platformë OTT, përmes së cilës transmetuesi publik synon ta bëjë përmbajtjen të aksesueshme edhe përtej transmetimit tradicional.

Pjesë e sezonit të ri do të jenë gjithashtu pesë produksione ndërkombëtare, nga serialet turke të dramës historike dhe produksionet evropiane. Paketa përfshin tituj që janë transmetuar ose shpërndarë më parë në tregje ndërkombëtare, mes tyre produksione të lidhura me Disney+, një serial të prezantuar në CANNESERIES, një dramë historike me kast ndërkombëtar dhe një miniserial me aktorin Can Yaman.

Programacioni nuk do të mbështetet vetëm te serialet. RTSH njoftoi se sezoni do të përfshijë spektakle, filma, dokumentarë dhe programe për fëmijë, ndërsa aktualiteti dhe debatet politike do të vijojnë të jenë pjesë e fashës kryesore të transmetimit.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Politikë

"Në 100 orët e para, s'kam pushuar asnjë sekondë!" Spahiu me premtime për Onkologjikun: Unë përballim nëse nuk ofrohen shërbimet mjekësore



Politikë

"Njerëzit e punës s'mund të përgojohen", ministria e Shëndetësisë premtim në Kuvend: Ose e sjell atë PET Scan ose jap DORËHEQJEN

Zbuloj më shumë artikuj >

Logo dhe grafikë e re nga 21 shtatori

Një prej ndryshimeve më të dukshme është identiteti vizual. Prej disa javësh, RTSH ka publikuar në ekran dhe në rrjetet sociale mesazhe si “Diçka po lind”, “E kuqja ka histori”, “Historia jeton” dhe “Horizonti po ndryshon”, si pjesë e fushatës që parapriu prezantimin.

Identiteti i ri mbështetet në një formulë më minimale, me emrin RTSH dhe një element rrethor që përshtatet sipas kanalit. Sipas prezantimit të bërë nga televizioni publik, grafika e re do të përdoret jo vetëm në transmetimin televiziv, por edhe në aplikacione, faqen online, YouTube, Instagram dhe formate të tjera digjitale.

Ngjyra e kuqe ruhet si një prej elementeve qendrore të identitetit. Pamja e re, e prezantuar gjatë aktivitetit, pritet të shfaqet në transmetim për publikun më 21 shtator.

Drejtoresha e Përgjithshme e RTSH-së, Eni Vasili, tha se ndryshimi vizual është pjesë e një procesi më të gjerë që synon të kalojë institucionin nga faza e riorganizimit të forcimit i pozicionit të tij në tregun mediatik.

“Tani RTSH duhet të kalojë nga normalizimi i institucionit, që ndodhi në vitin e kaluar, të marrja e një vendi dinjitoz në tregun mediatik shqiptar”, tha Vasili.

Ajo bëri të ditur se në sezonin e ri do të ketë edhe prezantues dhe autorë të rinj. Sipas saj, përzgjedhja është mbështetur te profesionalizmi, energjia dhe marrëdhënia me publikun.

Platforma OTT dhe ndryshimet në mënyrën e transmetimit

Një tjetër projekt i prezantuar është platforma OTT e RTSH-së, e cila synon t’u japë përdoruesve mundësi për të ndjekur përmbajtjet përmes internetit dhe pajisjeve të ndryshme, duke e afëruar transmetuesin publik me modelin e platformave streaming.

Në aktivitet ishte e pranishme edhe Radka Betcheva, drejtuese e marrëdhënieve me anëtarët për Evropën Qendrore dhe Lindore në Unionin Evropian të Transmetuesve (EBU). Ajo e lidhi zhvillimin e platformës me ndryshimin e mënyrës se si audiencat konsumojnë sot përmbajtjen mediatike.

“Platforma e re OTT është një shembull shumë i mirë. Të shkosh aty ku ndodhet sot audiencia nuk do të thotë të largohesh nga misioni i shërbimit publik”, tha Betcheva.

EBU është përfshirë gjithashtu me ekspertizë në procesin e reformimit të RTSH-së. Sipas Vasilit, bashkëpunimi ka përfshirë rishikimin e strukturës së institucionit dhe pritet të lidhet edhe me ndryshime ligjore.

Betcheva tha se transformimi i RTSH-së duhet parë në kontekstin më të gjerë të ndryshimeve që po kalojnë mediat publike evropiane për shkak të teknologjisë dhe zhvendosjes së audiencave drejt platformave digjitale.

Në prezantimin e sezonit të ri morën pjesë gjithashtu përfaqësues të qeverisë, mes tyre ministri Blendi Gonxhja dhe ministrja Mirela Kumbaro, si dhe gazetarë, artistë dhe figura të televizionit.

Me ndryshimet e paralajmëruara, RTSH po ndërhyr njëkohësisht në tri drejtime: në mënyrën si paraqitet vizualisht, në përmbajtjen e programacionit dhe në mënyrën se si kjo përmbajtje shpërndahet. Identiteti i ri vizual pritet të jetë ndryshimi i parë që do të shohë publiku në ekran nga 21 shtatori, ndërsa programet dhe produksionet e reja do të shtrihen përgjatë sezonit televiziv.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu





🕒 E Enjte 13:39

Tensione dhe përplasje në protestë, 11 persona shoqërohen në komisariat



Aktualitet

Vodhën me dhunë xhiron në dy pika karburanti në Bulqizë, policia identifikon njërin prej autorëve

🕒 E Enjte 13:23



Aktualitet

Gjykata e Tiranës liron 12 protestuesit e ndaluar: Arrestimi i tyre, i paligjshëm

🕒 E Enjte 13:08



🕒 E Enjte 12:55

ZBARDHET skema! Si u tjetërsuan tokat në Seman, biznesmeni bashkëpunoi me ish-zyrtarët e Kadastrës, momenti i shoqërimit me "Bentley" (VIDEO)



Aktualitet

Haga i vulosi 25 vite burg, bashkëshortia e Jakup Krasniat



Aktualitet

Protestuesit tentojnë të çajnë kordonin e policisë. shoqërohet

nxjerr mesazhin që ai i dërgoi pas vendimit

E Enjte 12:38

Dritan Goxhaj, bashkë me të dhe dy qytetarë të tjerë (PAMJE NGA TENSIONET PARA KUVENDIT)

E Enjte 12:25



E Enjte 11:32

Përplasje mes policit dhe qytetarit te ministria e Brendshme, protestuesit "s'i mbajnë nervat": Hiqe uniformën po ta mbajti b*tha, ta tregon babi im qejfin ty



Aktualitet

Ndalimi i telefonave në seanca gjyqësore, GJKKO i përgjigjet Dhomës së Avokatisë: Ndalimi i tyre është një mase për ruajtjen e rendit dhe sigurisë

E Enjte 11:25

Aktualitet

Përmirësimi i trajtimit të pacientëve me probleme të shëndetit mendor, ekspertët europianë asistojnë stafin e burgut në Lezhë

E Enjte 11:22



E Enjte 10:54

Seanca plenare nis me dënimin e vendosur për ish-krerët e UÇK-së, Peleshi: Një vendim i dhimbshëm, jo vetëm për Kosovën, por edhe për

historinë tonë kombëtare



Aktualitet

SHTYHET gjyqi Meta-Kryemadhi, kreu i PL-së thotë se nuk ka fashikujt e dosjes, ish-gruaja e tij "në dorë" 180



Aktualitet

Akuzohet se plagosi me drapër babain e ish-bashkëjetueses së tij, lihet në burg daja i Zegjine Çaushit

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.